



UNIVERSITETI I PRISHTINË

“HASAN PRISHTINA”

UNIVERSITY OF PRISTINA

FAKULTETI I NDËRTIMTARISË – CIVIL ENGINEERING FACULTY

Rr. Agim Ramadani, ndertesa e “Fakultetit Teknik”, 10000 Prishtinë, Kosovë

Tel: +383-38-548 644

URL: <http://www.fna.uni-pr.edu>

Mail: [fn@uni-pr.edu](mailto:fn@uni-pr.edu)

Ref. nr. 1102/1 Prishtinë 04.05. 2023

## PUBLIKIMI I ABSTRAKTIT TË PUNIMIT TË DIPLOMËS MASTER

### DEPARTAMENTI HIDROTEKNIK

Studenti **Korab Morina** ka dorëzuar dorëshkrimin e punimit të diplomës Master me titull: “ **Hidrocentralet e vogla dhe studimi mbi ndërtimin e HCV Orqushë** ” në programin e studimeve Hidroteknik dhe dorëshkrimi është në procedurë të vlerësimit përfundimtar deri në vendimin e këshillit të Fakultetit të Ndërtimtarisë. Sipas rregullores për studimet Master Shkencor të Universitetit të Prishtinës, abstrakti i shkurtër i punimit të diplomës bëhet publik për periudhën kohore prej pesë ditësh nga dita e shpalljes.

### Abstrakti

Kërkesa në rritje për konsum të energjisë elektrike dhe me trendet bashkëkohore të prodhimit të energjisë elektrike, Republika e Kosovës është duke shkuar në një të ardhme të paqëndrueshme. Në mënyrë që të kemi të ardhme të qëndrueshme duhet të synohet në modelin e prodhimit të energjisë elektrike përmes burimeve të ripërtëritshme të energjisë. Pra duhet të i jipet përparësi studimit dhe zhvillimit të prodhimit të energjisë elektrike nga burimet e ripërtëritshme- hidrocentraleve.

Në vendin tonë, në lokacione të studiuara kemi mundësi prodhimit të energjisë elektrike nga hidrocentralet në vlerën 128.0 MW apo prodhim vjetor 621.0 GWh/vit. Ky punim diplome tregon studimin për ndërtimin e mundshëm të hidrocentralit të vogël në fshatin Orqushë, Komuna e Dragashit, për furnizimin e shpenzuesve me energji elektrike, në mënyrë të sigurtë dhe të besueshme. Në vendet në zhvillim siç është vendi ynë, rol kyç për nxiten e investimeve të reja e luan siguria e furnizimit me energji elektrike. Kështu që ideja kryesore e këtij punimi është në zhvillimin e projektit që ka të bëjë me ndërtimin e kësaj njësie të re prodhuese.

Ky punim diplome përfshin studimin hidrologjik, gjeologjik, dimensionimin bazik të impiantit të hidrocentralit, analizën financiare, analizën e ndikimeve mjedisore. Përfundimi i këtij punimi është rekomandim që në vendin e studiuar kemi mundësi të ndërtimit të hidrocentralit.

**Fjalët kyçe:** energji elektrike, burime të energjisë së ripërtëritshme, hidrocentrale, studim hidrologjik, studim gjeologjik, dimensionim, analizë financiare, analizë e ndikimeve mjedisore

Dorëshkrimi i punimit është i atashuar në sekretarinë e Fakultetit të Ndërtimtarisë dhe është i qasshëm për publikun. Çdo vërejtje, plotësim, ndryshim mund të deponohet me shkrim i protokolluar dhe do të merret për trajtim nga këshilli i Fakultetit të Ndërtimtarisë.